



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
06Nr 111/01-6653 dt 07/02/2024



Duke u bazuar në nenin 77 parag.1, neni 80, 81 të Ligjit për Zyrtarët Publikë nr. 08/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr.03/L-212, neni 4 dhe 5 i Udhëzimit Administrativë nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, neni 21 i Udhëzimit Administrativë për Kujdesin Parësor Shëndetësor nr.04/2020, gjithashtu bazuar në Njofimin nr 06-070/03-3378 dt.18/01/2024 për Anulim të Konkursit nr 06-111-57769 te dt. 12.12.2023, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nxjerr këtë:

RISHPALLJE TË KONKURSIT

Për Plotësimin e Vendit të lirë të punës

Titulli i vendit të punës: Zëvendësdyrëtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr.Hafir Shala”
Drenas

Kategoria dhe grada e vendit të punës: Klasa H4/koeficienti: 12.5

Orari i punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e Kontratës: Me mandat 4 vjeçar

Mbikëqyrja: Drejtori i QKMF-së

Përshkrimi i detyrave të punës:

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS

1. Në bashkëpunim me drejtorin sigurojnë shërbim cilësor në shëndetin primar për të gjithë popullatën e qytetit me rrethinë pa dallim.
2. Ndihmon në aftësimin e metejshëm të personelit mjekësor dhe stafit tjetër të këtij Institucioni shëndetësor.
3. Është përgjegjës dhe këshilltar i Drejtorit të QKMF-së në lidhje me implementimin dhe zhvillimin e mjekësisë familjare në Komunën e Drenasit.
4. Përkujdeset për furnizim të rregullt me material të nevojshëm nëpër shërbime dhe njësitë punuese .
5. Kontribuon në zhvillimin, sistemin e përpilimit të raporteve nga tereni dhe të njejtat raporte t’ia dorëzoi Instituti Publik të Shëndetësisë apo sipas nevojës edhe DSHMS-së.

6. Ndihmon në përgaditjen e buxhetit një vjeçar dhe planin vjetor të punës për shëndetësinë primare të komunës dhe të njejtat të i'a prezentoj drejtorisë së institucionit përkatës dhe drejtorisë së shëndetësisë.
7. Koordinon orarin e kujdestarive gjatë vikendeve dhe festave, përgaditë orarin e punës për mjek të QKMF, QMF, AMF.
8. Ka për obligim bashkëpunimin e ngushtë me zyrën e personelit dhe stafin udhëheqës në kuadër sektorit të Administratës së QKMF-së.
9. Merr pjesë në realizimin maksimal të shpenzimeve të buxhetit në shëndetësinë primare, duke u bazuar në prioritetet dhe nevojat.
10. Bashkëpunon në kordinim dhe udhëheqjen me ekipin për punë nga shefat e sektoreve, njësitë dhe për përgjegjësitë e shërbimeve duke përkrahë punën ekipore.
11. Kryen edhe punë tjera sipas urdhërësës së Drejtorit të QKMF-së dhe në mungesë të drejtorit të QKMF-së merr të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë në lidhje me mbarëvajtjen e punës në Qendren Kryesore të Mjekësisë Familjare në Drenas.

Kushtet e Konkursit :

Kandidati/ja të cilët konkurojnë për këto pozita përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj duhet të kenë të përfunduar :

- Fakultetin e Mjekësisë-Mjek specialist i Mjekësisë Familjare, Licencën e punës ,
- Fakulteti Juridik-jurist/e i/e diplomuar,
- Fakultetin Ekonomik-ekonomist/e i/e diplomuar
- 5 vite përvojë pune në profesion

Dokumentet e kërkuara :

- Kopja e Diplomës së Fakultetit (të vërtetuar)
- Kopjen e Licencës së Punës të vërtetuar -vërtetim për përvojën e punës
- Çertifikatën e Lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Çertifikatën që nuk është nën hetim
- Çdo dokument tjetër apo çertifikatë trajnimi që kandidat-i/ja e vlerëson të nevojshme që i përshtatet kushteve dhe kriterëve të përcaktuara më lartë.

Të preferuara:

- Dëshmi mbi njohjen bazike të punës me kompjuter .
- Çertifikatë të trajnimit në menaxhim shëndetësor.

Cdo aplikues duhet të plotësoi dhe dorëzoi dokumentacionin me sa vijon :

- Fletë aplikacionin e plotësuar
- Dokumentacionin mbi përgatitjen dhe kualifikimin profesional/kopje e noterizuar (vërtetuar)

Të gjithë kandidatet të cilët hyjnë në listën e ngushtë, do të ftohen në intervistë, dhe për datën e mbajtjes së intervistës do të njoftohen me kohë dhe do të intervistohen nga komisioni përzgjedhës .

Kandidati i përzgjedhur nga ana e komisionit duhet të sjellë Certifikatën e Mjekut.

Data e shpalljes së Konkursit: 08.02.2024 deri me 08.03.2024.

Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. Aplikacionet mirren dhe dorëzohen të kompletuara në Qendren për Shërbimin me Qytetar (kati I sporteli 8 dhe 9) Komuna Drenas. Dokumentacioni i cili nuk ju përgjigjet kriterëve të konkursit, dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai që arrinë me vonesë nuk do të shqyrtohen.